



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10
Nr. i fazeve St. fazeve	4
Nr. Prot. Br. Prot.	10-02061-0017304 25
Data Datum Date	23/10/2025



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

ODBOR ZA POLITIKU I FINANSIJE

COMMISSION FOR POLITICS AND FINANCE

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMITETIT PËR

POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal

16.09.2025

Takimi i mbajtur me datën 16.09.2025 në hapësirat e Komunës së Mitrovicës Veriore me fillim në ora 15:00.

Në takim janë të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Nedzad Ugljanin
2. Flutura Hamza - Azemi
3. Aida Ferati - Doli
4. Gzim Alushi

Të pranishëm të tjerë: mediat lokale, përfaqësues të misioneve ndërkombëtare dhe përfaqësues nga Drejtoria e Financave.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa, z. Nedzad Ugljanin, i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit.

Rendi i ditës sipas rregullores së kuvendit:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
2. Miratimi i buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028
3. Kërkesat e qytetarëve
4. Të ndryshme

Kryesuesi njofton se anëtari Dusan Milunovic, për shkak të angazhimeve të tij, do të mungojë sot në takim. I njëjti ka pasur një kërkesë që të bëhet një raport i secilit anëtar të kuvendit për të raportuar punën e tij gjatë gjithë mandatit. Unë raportin e bëj në kuadër të kuvendit dhe vendimeve që merren, dhe nuk më duket në rregull, por mendoj se në kohë fushate ata dëshirojnë të shfrytëzojnë kohën. Ne si kuvend duhet të përmbahemi statutit dhe të jemi në shërbim të qytetarëve; fushata duhet të jetë jashtë këtij objekti dhe jo brenda. Jam kundër që kjo të promovohet në kuadër të kuvendit apo komisioneve.

Në email ka ardhur një kërkesë nga Musa Miftari nga Lagjia e Doktorëve për energji elektrike, ku ne kemi pasur takime me zv. kryesuesin dhe me qytetarët, ku kemi pasur edhe peticionin. Këtë temë do ta hapim edhe në kuvendin komunal, meqenëse këtë email e ka dërguar tek të gjithë asambleistët. Kam biseduar me përfaqësues të Elektroservisit pas debatit me qytetarët, mirëpo ata mbrojnë marrëveshjen e Brukselit, ku janë kompani e pavarur dhe ne nuk mundemi ligjërisht të ndërmarim asgjë për këtë lloj marrëveshjeje. Nëse dikush ka ndonjë propozim, meqenëse muajin tjetër do kemi raportet për mbledhjen e fundit.

Aida: Nëse më lejohet, kjo kërkesë e Dushanit më duket e pakuptimtë, nuk ka asnjë bazë.

Kryesuesi: E kuptova që nuk ka bazë. Në fakt, ai dëshiron të promovojë veten në kohë fushate, ku i kërkoja të bëjmë një mbledhje në fund të muajit, por më tha se nuk i përshtatet.

Aida: Nëse ai dëshiron të promovojë veten në kohë fushate, atëherë ka rrjetet sociale dhe mënyra të tjera, mirëpo raport ti kërkoj dikuj nuk mundet.

Kryesuesi: Vendimet i marrim së bashku dhe nëse dikush është kundër, është e drejtë e tyre. Unë dhe znj. Naxhije, si kryesuese e Komisionit për Komunitete, dhe z. Skender, si zv. kryesues, japim raportet që janë në ligjshmëri për pushtetin lokal. Por unë jam ai që duhet të përcjell kërkesat e tij, megjithatë nuk jam dakord që dikush të promovohet me këto kërkesa. As vetes nuk ia lejoj një gjë të tillë. Vetëm jashtë institucioneve mund të bëjmë fushata politike, por jo brenda në kuvend, ku madje as kryetari nuk i lejohej të bëjë fushatë politike në kuadër të institucionit komunal.

Kryesuesi: Hedh në votim rendin e ditës. Kush është për këtë rend dite?
Rendi i ditës votohet me 4 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi: Kalojmë te pika e parë, miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar. Kush është për?
Procesverbali nga takimi i kaluar votohet me 4 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi: Kalojmë te pika e radhës: miratimi i buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028, ku drejtoresha Mevlude Shala do të raportojë projektbuxhetin për vitin 2026.

Mevlude: Përshëndetje për të gjithë, jam sot para jush për ta paraqitur projektbuxhetin për vitin 2026.
(Znj. Mevlude fillon të paraqesë raportin për buxhetin.)

Kryesuesi: Faleminderit drejtoresha. Do të ketë pyetje për kryetarin në ditën që vjen, sepse investimet kapitale që kemi votuar për në Kodrën e Minatorëve tashmë dy vite nuk kanë përfunduar. Projektet kapitale për 400.000 € dhe qeveria ka ndarë mbi 300.000 €, por aty nuk ka filluar asgjë në fakt. Kam kërkuar edhe vitin e kaluar renovimin e urës në lagjen e Boshnjakëve dhe do të bisedoj, sepse nuk di nëse do të shkojë përmes bordit të drejtorëve apo përmes investimeve kapitale komunale. Janë dy pyetje që do të bëhen, dhe janë edhe vendimet për shujta që duhet të aprovohen nga zyra e kryetarit dhe pagesa e anëtarëve të Komitetit për Komunitete. Këto duhet të përfundojnë deri në fund të muajit, dhe unë nuk do të marr pjesë në votimin e buxhetit, jo vetëm unë, por edhe anëtarët e tjerë. Dje kemi pasur takim me anëtarët e Komitetit për Komunitete, të cilët prej një viti nuk janë paguar. Nëse nuk përfundojnë pagesat deri në fund të muajit, kam nisur procesin edhe me avokat për shujtat që kemi sjellë vendimin, dhe nuk do të marr pjesë në votimin e buxhetit. Për këtë kam dhënë kohë drejtoreshës që nga data 22 deri në fund të muajit që këto pagesa dhe vendime të realizohen sa më parë. Nëse nuk realizohen, nuk do të thërras mbledhje deri në fund të muajit. Do të njoftoj edhe kryetarin për masat që do të marrë, sepse neglizhenca ndaj anëtarëve të kuvendit nga kryetari ka arritur kulmin. Ai nuk ka marrë pjesë në 6 apo 7 mbledhje dhe nuk ka pasur takim me kryesuesin e kuvendit për afërsisht një vit, pa asnjë konsultim. E drejta e kryesuesit është të mbrojë interesat dhe vendimet që kemi sjellë së bashku në kuadër të kuvendit. Ju tregoj sinjerisht që pa përfunduar këto nuk do të thërras mbledhje për miratimin e buxhetit. Ju e dini që Zubin Potoku ka pasur vështirësi për mosmiratimin e buxhetit. Ne deri më tash kemi vepruar gjithmonë në interes të zyrës së kryetarit dhe të shtetit të Republikës së Kosovës për forcimin Institucional në pjesën veriore, në bazë ligjore i kemi miratuar, mirëpo që një vit kryetari ka qenë i obliguar të ketë ndonjë takim me kryesuesin, sidomos kur ti bëjnë këto plane infrastrukturore dhe kapitale, sepse ne jemi të zgjedhur nga qytetarët dhe mbrojmë interesat e tyre dhe të jenë të kyçur në investime kapitale, sepse këtu në fakt na është imponuar që unë si kryesues nuk do ta pranoj. Keni kohë deri në fund të muajit ta njoftoni kryetarin meqë s'po gjen kohë të takohet me mua. Ju e dini se kam liruar mbledhjen dhe se si ka ndodhur, sepse unë s'jam pjesë dhe as s'do jem deri në përfundim të mandatit pjesë e pazareve politike. Kredibilitetin tim dhe të asambleistëve nuk e lejoj që dikush të shfrytëzojë si marionetë, sepse ne kemi kredibilitetin tonë. Ju e dini se afër një vit kryetari nuk më ka ftuar në kabinet të diskutojmë për problemet dhe vendimet që kemi pasur, ku unë nuk mundem të merrem me problemet e kryetarit, por merrem me probleme të asambleistëve. Për ato që ne votojmë ne duhet të vendosim, jo të tjerët, sepse jemi para aktit të kryer. S'jam për mosvotimin e buxhetit sepse kalon afati kohor. E di sa probleme ka pasur Zubin Potoku ku janë në pyetje edhe pagesat në kuadër të administratës dhe drejtorisë, por ka kohë deri në fund të muajit. Unë me datë 22 do të thërras mbledhje, mirëpo nëse nuk përmirësohen këto, buxheti nuk do të votohet. Kaq nga unë, nëse keni diçka ju urdhëroj.

Mevludë: Është e drejta e juaj, s'kam çfarë të shtoj unë, mirëpo e dini rëndësinë e buxhetit, është dokumenti kryesor komunal, aprovimi i buxhetit. E dini sa probleme po ka Prishtina dhe komunat tjera që s'e kanë aprovuar.

Kryesuesi: Unë këtu e shoh që shëndetësia për 3 vite janë rikthyer mbi 9 milionë €, kurse mbi 6.7 milionë €, kurse për shujta që i takojnë çdo komune, sepse në vendimin e kemi dhe ligjërisht është aprovuar, dhe ne sikurse komunat tjera po dëshirojmë t'i mbrojmë interesat e ekzekutivit, sepse përmes shujtave nuk dëmtohet buxheti. Kemi biseduar edhe me përfaqësues të komunave tjera, ku ato komuna kanë përfituar, dhe problemi i anëtarëve të komitetit për komunitete, të

gjitha komunat i kanë përfunduar obligimet ndaj anëtarëve të komisioneve për komunitete, ku vetëm komuna jonë s'ë ka përfunduar ende pagesat. Meqë janë të përzgjedhurit tanë, në situatë më të vështirë e kanë pranuar të detyrohen të jenë pjesë e atij komisioni. Në çfarë mënyre do ta përfundojmë këtë buxhet jam dakord të votojmë por me ndryshime, por pa përfunduar ato pagesa nuk do votojmë.

Gzimi: Unë qëndroj prapa kërkesës tende, nëse ti nuk e voton, as unë nuk do ta votoj.

Mevludë: Nuk më takon mua të komentoj, mirëpo është një dokument i rëndësishëm për komunën tonë.

Kryesuesi: E dimë rëndësinë e buxhetit edhe për ne edhe për ekzekutivin.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e radhës, kërkesat e qytetarëve, nuk ka asnjë kërkesë.

Kryesuesi: Kalojmë në pikën e fundit, të ndryshme. A keni diçka për të shtuar?

Kryesuesi: Falenderoj të gjithë anëtarët, sa kam pasur mundësi kam ndihmuar, kemi pasur një bashkëpunim të mirë dhe kemi pasur një ankesë nga një asambleist nga komuniteti serb dhe është e drejtë e tij. Nëse nuk keni diçka për të shtuar, ju uroj suksese në fushatën zgjedhore.

Aida: Secili asambleist ka të drejtë të flasë për punët që i ka bërë, nuk ka të drejtë të kërkoj që të votoj këtë apo atë numër, mirëpo kërkesën e z. Dushan që ka kërkuar të raportojë secili asambleist, meqë jemi në fund të mandatit, se di edhe sa mbledhje do mbahen. Miepo kjo legjislaturë është ajo që ka bërë shumë punë të mira dhe jo vetëm individualisht, ka qenë një legjislaturë e mirë dhe ju uroj suksese secilit dhe uroj që në legjislaturën e ardhshme të ketë zëra më të fuqishëm që të përfundojnë punë për secilin komunitet. Dihet se kur fillon fushata, ne s'mundemi t'ua ndalojmë askujt, është një fazë që është e ndaluar në institucione dhe në shkolla që mos të bëjmë thirrje se ke të votojmë, gjithsesi s'mundemi të ndalojmë të tjerët.

Kryesuesi: Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

Procesmbajtës:

Bujar ISUFI



Kryesuesi i Komisionit për Politikë dhe Financa:

Nedžad UGLJANIN

